

RAMADAN ZEJNUNI



Auditues i Lartë, Departamenti i Kontrollit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrolli i Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Lindur në vitin 1949. Diplomuar në Ekonomi, dega Financë(1973). 41 vite eksperiencë pune. 16 vitet e fundit eksperiencë pune në KLSH. Auditues i Lartë nga muaji mars 2013. Fusha e ekspertizës: Auditimi i

tenderave publikë dhe i buxhetit.

AUDITIMI MË I LARTË PUBLIK DHE QEVERISJA E MIRËⁱ

nga Ramadan Zejnuni

Auditimi më i lartë (suprem) publik përfaqësohet nga institucioni kushtetues i Kontrollit të Lartë të Shtetit(KLSH). Një qeverisje e mirë do të thotë njohje, respektim dhe zbatim i ligjeve, si dhe një kulturë të lartë në qeverisjen dhe menaxhimin e shoqërisë. Parimet e një qeverisjeje të mirë kanë si elementë kryesorë të tyre përgjegjësinë, ndershmërinë, pjesëmarrjen qytetare, konfidencialitetin, transparencën dhe hapjen e informacionit. Me përgjegjshmëri kuptohet përgjegjësia e zyrtarëve publikë, për formulimin, cilësinë dhe kohëzgjatjen e realizimit të politikave e programeve, rritjen e efikasitetit kontrollin e kostos dhe menaxhimin e zbutjen e tendencave të kundërta që rrjedhin nga zbatimi i programeve me dobi, kursim dhe frytëshmëri. Qeverisja e mirë përforcon sigurinë, integritetin dhe eficiencën e tregut, duke bërë kështu të mundur rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar të vendit.

Duhet theksuar se në dy vitet e fundit, KLSH po punon intensivisht dhe konkretisht për ta bërë më të përgjegjshme administratën publike. Vetëm

gjatë vitit 2012, institucioni kryer 40 kallëzime penale për 125 nëpunës të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 34 kallëzime më shumë, pothuajse 2 herë më tepër se sa 3 vitet 2009 (9 kallëzime)-2010 (5 kallëzime) dhe 2011 (6 kallëzime), të marra së bashku. Vetëm gjatë 5 muajve të parë të vitit 2013, KLSH ka çuar në prokuroritë përkatëse 16 kallëzime penale për 44 nëpunës të administratës shtetërore.

Në kallëzimet penale të bëra nga KLSH, si në ato të vitit 2012 ashtu dhe në ato të vitit 2013, janë denoncuar për konsumim të figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës, shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo falsifikimit, drejtues të lartë të administratës shtetërore si Drejtor Kabineti dhe Drejtorë të Përgjithshëm në Ministri, Kryetarë apo ish-Kryetarë Bashkie, drejtues të lartë në institucionet e ndryshme në rrethe, etj.

Gjithashtu, lufta kundër korrupsionit është shtrirë edhe brenda radhëve të vetë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe konkretisht në muajin janar të vitit 2013, KLSH ka dërguar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dy kallëzime penale për dy prej ish punonjësve të këtij institucioni, të cilët në shkelje të hapur të standardeve dhe procedurave të auditimit, kishin konsumuar elementët e figurës së veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit.

KLSH nxit qeverisjen e mirë nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve të tij të auditimit drejt njehsimit të plotë me standardet ndërkombëtare INTOSAI. Hartimi dhe zbatimi në praktikë i standardeve të reja të auditimit, bazuar në ato ndërkombëtare (ISSAI) dhe përshtatur për kushtet juridike dhe ekonomike të vendit tonë, ka bërë që të rritet cilësia e veprimtarisë audituese në të gjitha fazat, që nga planifikimi dhe deri tek raportimi. Këtë përshtatje dhe orientim të punës audituese me standardet ISSAI, Kryetari i KLSH Dr. Bujar Leskaj e ka kërkuar që në fillim të

mandatit të tij. Kjo ka bërë që të rritet akoma më shumë përgjegjshmëria dhe llogaridhënia e ne audituesve për materialet që përgatisim, duke vënë përballë jo vetëm subjektin e audituar por dhe institucionet e tjera të specializuara të auditimit dhe publikun e gjerë.

Përmirësimet e dukshme në vitet e fundit të veprimtarisë së gjithanshme të KLSH në funksion dhe të nxitjes së mirëqeverisjes, janë arritur në saj të një punë këmbëngulëse në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të burimeve njerëzore nëpërmjet seminareve e trajnimeve brenda dhe jashtë vendit, riaktivizimit dhe zgjerimit të bashkëpunimeve me institucione homologe me përvojë, si NIK-u polak, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Gjykata e Llogarive e Turiqsë, kolana e botimeve KLSH, si dhe tubimet dhe konferencat shkencore, etj.

Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme, për t'u siguruar se politikat shtetërore janë zbatuar siç duhet në dobi të qytetarëve, janë realizuar strategjitë dhe mbi të gjitha, performanca e qeverisjes ka arritur ose jo nevojat dhe pritjet e publikut brenda kuadrit ligjor dhe rregullativ. Është përgjegjësi e KLSH të vlerësojë, ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficiencën e zbatimit të programeve dhe aktiviteteve qeveritare, për të siguruar përputhjen me standardet përkatëse dhe legjislacionin në fuqi.

KLSH do të vazhdojë të luajë një rol aktiv në ngritjen e vetëdijes për rrezikun e mashtrimit dhe korrupsionit dhe forcimin e qeverisjes së mirë, si dhe zbatimit të standardeve të etikës. Funkzioni kryesor i KLSH në këtë luftë është nxitja e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit dhe korrupsionit, duke përfshirë forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e mangësive.

ⁱ Botuar në Gazetën "Metropol" dt. 23 Korrik, 2013